



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALLAKASTËR**  
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE**  
**MBËSHTETËSE**  
**Sektori Juridik**

Nr. 1636 Prot.

Ballsh më, 09 . 04 .2026

**Lënda: Thirrje për shprehje interesi për të marrë pjesë në Këshillin Vendor të Rinisë**

Bazuar në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të pikës 3 të nenit 10 të ligjit nr. 75/2019 “Për rininë”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Mallakastër nr. 12, datë 28.02.2026 “Për miratimin e kritereve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij”, kryhet kjo thirrje për shprehje interesi për të marrë në Këshillin Vendor të Rinisë (KVR) së Bashkisë Mallakastër. Në bazë të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Mallakastër nr. 12, datë 28.02.2026, KVR përbëhet nga 7(shtatë) anëtarë, ku të respektohet parimi i barazisë gjinore.

KVR do të ketë në përbërje:

- a) Kryetari i Bashkisë, kryetar;
  - b) Përfaqësues nga organizatat rinore ose organizatat për të rinjtë Bashkëkryetar;
  - c) Përfaqësues i Këshillit Bashkiak ose administratës (sektori i rinisë) së njësisë administrative, anëtar;
  - ç) 2 përfaqësues nga organizatat rinore ose organizatat për të rinjtë (anëtarë);
  - d) 2 përfaqësues nga të rinj aktiv të Njësisë Administrative (anëtarë)
- Anëtarët e KVR emërohen me urdhër të Kryetarit të Bashkisë dhe mandati i tyre është dy vjeçar, me të drejtë riemërimi.

-Aplikuesit për anëtar të KVR duhet të paraqesin pranë Bashkisë Mallakastër deri më **datë 22.04.2026** dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) kërkesë me shkrim ku të shprehë interesin për aplikim;
- b) jetëshkrim;
- c) vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- d) vetëdeklarim lidhur me shmangien e konfliktit të interesave;

Përzgjedhja mes individëve që kanë shprehur interes nga këshilli bashkiak dhe/ose administrata e njësisë administrative bëhet nga kryetari duke u bazuar në kriterin e përvojës së mëparshme me organizatat jofitimprurëse dhe në projekte që lidhen me të rinjtë.

**KRYETAR**

Qerim Ismailaj

